REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 10720 prot. Lushnjë, më 02.11.2026

NJOFTIM

Lënda: "Për shprehje interesi nga subjektet privatë për vendosjen e lojërave argëtuese në hapësirat publike të përcaktuara nga Bashkia Lushnjë."

Bashkia Lushnjë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar; ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore", të ndryshuar; VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Lushnjë nr. 114, datë 21.11.2025, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore,administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative" ndryshuar me V.K.B nr. 15, datë 22/01/2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr.114 datë 21.11.2025 për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative", në kuadër të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve dhe krijimit të një atmosfere festive në prag të festave të fundvitit, fton të gjithë subjektet e interesuara të paraqesin kërkesat e tyre për vendosjen, instalimin, dhe administrimin teknik të lojërave argëtuese në hapësirat publike të përcaktuara nga Bashkia Lushnjë.

1. Fokusi i thirrjes

Bashkia Lushnjë hap këtë thirrje me qëllim ofrimin për qytetarët të një atmosfere sa më të bukur, festive dhe argëtuese në qytet, në prag të festave të fundvitit.

Thirrja u drejtohet të gjithë subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave argëtuese për fëmijë dhe që janë të interesuar të ofrojnë këtë shërbim në hapësirat publike të qytetit të Lushnjës , të cilat Bashkia Lushnjë do të vërë në dispozicion si më poshtë:

- Sheshi qendror para Bashkisë Lushnjë, në një sipërfaqe deri në 350 m^2 nga data 25/11/2026 deri më datë 10/01/2027.

2. Kriteret e aplikimit

Thirrja është e hapur për të gjithë subjektet që ofrojnë shërbime në fushën e lojërave argëtuese për fëmijë, të cilat pozicionohen dhe vendosen në ambiente të hapura publike.

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin, brenda datës 12.11.2026, ora 16:00 dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë për shprehje interesi për vendosjen e lojërave argëtuese;
- Projekt Ide (Projekt-ideja duhet të specifikojë qartë: mënyrën e menaxhimit të shërbimit; cilësinë dhe sasinë e lojërave që do të vendosen; organizimin dhe shfrytëzimin e hapësirës; kohëzgjatjen e aktivitetit/shërbimit; mënyrën e administrimit

dhe mirëmbajtjes; garantimin teknik dhe funksional të të gjitha lojërave që do të vendosen dhe përmes të cilave do t'u ofrohet shërbimi fëmijëve dhe qytetarëve; masat e parashikuara për garantimin e sigurisë së përdoruesve);

- Licensë për ushtrimin e aktivitetit;
- Çertifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS-in dhe vërtetimin për likuidimin e detyrimeve tatimore vendore;
- Deklaratë përgjegjësie e aplikuesit;
- Përshkrimin teknik të pajisjeve që do të vendosen (katalogë, manuale të pajisjeve, etj.);
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që subjekti/administratori nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

3. Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet referuar Projekt-Idesë të paraqitur nga subjektet e interesuara.

Tarifa e zënies së hapësirës publike është e përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Lushnjë me nr. 114, datë 21.11.2025, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore,administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative" ndryshuar me V.K.B nr. 15, datë 22/01/2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr.114 datë 21.11.2025 për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjës dhe penalitetet për kundravajtjet administrative"

4. E RËNDËSISHME

Të gjithë subjektet e interesuara që do të bëhen pjesë e kësaj thirrjeje duhet të garantojnë, me përgjegjësi të plotë, sigurinë dhe gjendjen teknike të të gjitha lojërave dhe pajisjeve që parashikojnë të vendosin në hapësirat publike.

Lojërat dhe pajisjet duhet:

- të plotësojnë të gjitha kërkesat dhe standardet teknike dhe të sigurisë në fuqi;
- të jenë në gjendje të përshtatshme teknike dhe funksionale;
- të garantojnë sigurinë e jetës dhe shëndetin e përdoruesve;
- të mirëmbahen dhe kontrollohen në mënyrë periodike gjatë gjithë periudhës së përdorimit;
- të jenë të përshtatshme për përdorim nga fëmijët dhe qytetarët;
- të harmonizohen me karakterin dhe atmosferën festive të qytetit.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë Bashkisë Lushnjë brenda datës 12.11.2026 ora 16:00.

Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnjë, https://bashkialushnje.gov.al

KRYETARI
Eriselda SEFA